

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS, SHENJAVE DALLUESE PËRKATËSE, FLAMURIN, STEMËN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti ka si qëllim që të normojë furnizimin me uniformë dhe do të ndryshojë disa elemente të veçantë të uniformës së punonjësve të strukturave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Gjithashtu, ka për qëllim përmirësimin estetik të prezantimit në detyrë dhe sigurimin e një furnizimi bashkëkohor dhe sa më funksional me materiale të shërbimit të veshmbathjes të punonjësit zjarrfikës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të projektakteve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektvendimi është detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrotjjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ku përcaktohet se:

“Shërbimi i MZSH-së ka uniformën, me shenjet dalluese përkatëse, gradat, flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Aktualisht, strukturat e shërbimit të MZSH-së uniformat që përdorin janë të miratuara me Vendimin nr. 78, datë 06.02.2003 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes për policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, vendim i cili nuk ka të parashikuar pjesën e uniformave zjarrduruuese për personelin operues, si dhe specifikimet përkatëse

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

të artikujve (helmetë zjarrduruese, kapuç mbrojtje poshtë helmetës, xhaketë dhe pantallona, çizme, doreza zjarrduruese, si dhe sistemi pér ndriçim).

Miratimi i këtij projektvendimi ndikon në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi në kuadër të mbështetjes pér kryerjen normale të detyrave funksionale, si dhe në kontribuimin jo vetëm pér mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve, por edhe pér të gjitha aktivitetet që lidhen me parandalimin e zjarreve, zjarreve në fondin pyjor dhe kulloso, apo pjesëmarrjen në situata të ndryshme emergjencash civile në territor, në aksidente e ndërhyrje, etj.

Projektvendimi përmirëson standardet mbrojtëse të punonjësve zjarrfikës, si nga pamja e jashtme dhe nga përbajtja, që u siguron këtyre punonjësve siguri gjatë kryerjes së detyrave, në përputhje me misionin e përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Punonjësit e strukturave të MZSH-së me miratimin e këtij projektvendimi bëhen me uniformë më funksionale dhe më praktike në përdorim, në raport me specifikën e këtij shërbimi, gjatë ndërhyrjeve në zjarre apo incidente të ndryshme teknike.

Disa nga risitë që sjell miratimi i këtij projektvendimi janë:

- Përmirësohet pamja e jashtme dhe prezantimi në detyrë i punonjësit zjarrfikës;
- Furnizimi i punonjësve bëhet me uniformë më funksionale dhe më praktike në përdorim, në raport me specifikën e këtij shërbimi, gjatë ndërhyrjeve në zjarre apo incidente të ndryshme teknike;
- Për funksione e struktura të veçanta, jepen artikuj uniforme më specifike (zjarrduruese) dhe me afate përdorimi që përputhen me detyrat që kryen e zgjidh funksioni apo gjithë struktura që trajtohet me këtë normë furnizimi.

Hartimi i projektvendimit “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” është një domosdoshmëri pasi gjatë përdorimit në vite të uniformës ekzistuese e miratuar nëpërmjet Vendimit nr. 78, datë 06.02.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes pér policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe zbatimit të normave të furnizimit me veshmbathje, janë konstatuar disa mangësi kryesisht në drejtim të pamundësisë dhe të mos qenies funksionale në përdorim të disa elementeve të veçantë të uniformës, apo dhe të afateve të përdorimit të disa artikujve të veshmbathjes.

Relacion shpjegues pér projektvendimin “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Efektet e pritshme të këtij projektvendimi janë pozitive, pasi synohet përmirësimi estetik dhe funksional në përdorim i uniformës, si dhe përshtatja e afateve të përdorimit të artikujve të uniformës me nevojat reale e në përputhje me detyrat e shërbimit që kryejnë punonjësit në funksione të ndryshme të strukturave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Me miratimin e këtij projektvendimi synohet të arrihet sigurimi i një pamje të jashtme sa më dinjitoze dhe të sigurtë, gjatë veprimtarisë operacionale të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe furnizimi me uniformë të përshtatshme dhe sa më funksionale, në afatin e duhur dhe sasinë e nevojshme, dhe plotësimi i të drejtave të punonjësve sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor/nënligjor.

Në nenin 5 të ligjit 152/2015 është përcaktuar që: “*Shërbimi i MZSH-së ka uniformën, shenjat dalluese përkatëse, gradat, flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Për sa i përket gradave ato janë miratuar me VKM nr. 895, datë 21.12.2015, ku në pikën 8 të tij përcaktohet se: “*Paraqitura, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij*”.

Ndryshimet në elemente të veçantë të uniformës, dhe shenja dalluese konsistonjë në përmirësimin estetik të tyre dhe bërjen sa më funksionale në përdorim të artikujve të uniformës, si dhe në sinkron me ndryshimet strukturore në zbatim të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar për miratim është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjithashtu është hartuar në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.152, datë 21.12.2015. "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe është në harmoni të plotë me legjisacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga 9 pikë.

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet miratimi i uniformës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas lidhjes se projektvendimit, shenjat dalluese përkatëse, flamuri dhe stema përkatëse e MZSH.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet që llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë për nivelin e mesëm dhe të lartë, janë të përcaktuara në lidhjen nr. 1 të tij.

Në pikën 3, evidentohet se në lidhjen nr. 2 janë të përcaktuara llojet e uniforms që do të përdorin punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë për nivelin bazë (operues).

Në pikën 4, parashikohen llojet e uniformës, që kanë në përdorim punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për uniformat zjarrduruuese të personelit operues, zjarrëfikës.

Në pikën 5 përcaktohet se flamuri dhe stema janë simbolet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas modelit të lidhjes nr. 4

Në pikën 6, përcaktohen se cilat janë shenjat dalluese të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Duke i listuar si vijon: shenja e mbiemrit; shenja e kapelës; stema e MZSH-së, logo e bashkisë përkatëse dhe shirita ceremoniale.

Në pikën 7, të projektvendimit parashikohet se Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara me kerkësë dhe në emër dhe për llogari të njësive të vetëqeverisjes vendore kryen, procedurën e prokurimit të uniformave të shërbimit të MZSH-së. Ky parashikim është i nevojshëm pasi është vlerësuar nga ekspertët që prokurimi i përqëndruar ne rastin konkret do minimizoje efektet financiare, duke bërë të mundur realizimin e kësaj procedure me një kosto më të ulët. Gjithashtu Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” në raste përjashtimore, mund të zhvillojë procedurë prokurimi per një autoritet a një gup autoritetesh kontraktore, mallra a shërbime, që nuk janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së saj. Realizimi i procedurës së prokurimit nga një institucion për disa autoritete kontraktore, që janë njësítë, do të sillte që cilësia e uniformave të ishte në uniformitet dhe cilësi të njëjtë për të gjitha MZSH-të në njësitet e vetëqeverisjes vendore.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Në pikën 8 të projektvendimit shfuqizohet vendimi nr. 78, datë 06.02.2003 i Këshillit të Ministrave.

Në pikën 9 parashikohen institucionet që ngarkohen me zbatimin e projektvendimit që janë Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar dhe Kryetari i njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi janë ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në kuadër të hartimit të projektaktit për përllogaritjen e fondit limit dhe nevojat materiale sasiore të shërbimit të veshmbathjes për vitin 2020 e në vazhdim është realizuar përllogaritja e fondit limit dhe e nevojave sasiore, është bërë duke marrë në konsideratë, numrin e efektivit të punonjësve të nivelit të mesëm dhe të lartë, si dhe punonjësit operues të shërbimit zjarrfikës.

Referuar numrit aktual (strukturave në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore) të punonjësve të shërbimit të MZSH-së janë përllogaritur nevojat sasiore për uniforma për rreth 1220 punonjës, si dhe për efektivin punonjësve të nivelit të mesëm dhe të lartë që trajtohet me uniformë të përditshme, përafërsisht 170 veta, ndërsa për efektivin operues që do të trajtohet me uniformë të përditshme llogaritë janë bërë për përafërsisht 1050 punonjës (personel i nivelit bazë).

Sipas nevojave, në zbatim të normës ekzistuese, të llogaritur nga kartelat personale të veshmbathjes të secilit punonjës, kemi llogaritur nevojat me optimale përfurnizimin së paku me një uniformë përfektivat që, në bazë të Vendimit të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Këshillit të Ministrave nr.78, datë 06.02.2003, "Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes për policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", lidhjes nr.1, trajtohen me uniformë të përditshme.

Si çmime referuese për përllogaritjen e fondit, meqenëse ato nuk publikohen nga INSTAT, apo institucione të tjera, pasi janë artikuj specifike të shërbimit të MZSH-së dhe nuk gjenden në treg të lirë, janë marrë çmimet e tregut .

Drejtoria e MZSH-së ka bërë përllogaritjet për fondin limit për uniformat e personelit oficer përafërsisht (170 vetë) dhe personelit operues përafërsisht (1050 punonjës).

Çmimi i përafërt i një uniforme për personel oficer dhe personale operues është përafërsisht si më poshtë:

170 oficerë x 75.000 leke = 12.750.000 leke, për uniformen dimërore dhe verore me te gjithë aksesoret.

1050 (efektiv zjarrfikës) x 60.000 leke (cp) = 66.150.000 leke, për uniformen dimërore dhe verore.

Çmimi i një uniforme zjarrduruese për efektivet zjarrfikës është si me poshtë:
1050 x 150.000 cp=157.500.000 leke


Shuma totale për te gjithë efektin e MZSH-së prej 1220 punonjësish përafërsisht (170 oficere+1050 nivel baze operues) është 78.900.000 leke, uniforma e punës,

157.500.000 uniforma zjarrduruese,

Gjithsej 236.400.000, lekë.

PROPOZUESI

MINISTRI
SANDËRLLESHAJ



Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".